



Prishtinë: 22.12.2010

Kodi i ZRRE-së: V_327_2010

Nr. i Referencës: ZRRE/DMK_R_506_12_10

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 16 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat sipas Kapitullit 3, Nenit 14.6 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Dëshmitë e paraqitura nga palët;
4. Rekomandimin e DMK të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_R_506_12_10**;
5. Nenin 18 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;

Në mbledhjen e mbajtur më 22 dhjetor 2010 nxori këtë:

VENDIM

REFUZOHET pjesërisht ankesa e konsumatorit Abit Bilalli nga Fushë Kosova, si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.

Arsyetim

Konsumatori në ankesën e tij drejtuar DMK të ZRRE-së të 02.03.2009 ka apeluar përgjigjen e KEK Sh.A – Divizioni i Furnizimit – Departamenti për Konsumatorë të datës 19.02.2009 lidhur me kontestimin e ngarkesës së shfrytëzimit të paautorizuar.

- ✓ Me datë 19.09.2008 punëtorët e autorizuar të KEK-ut kanë inspektuar pikën matëse të konsumatori dhe kanë konstatuar se njehsori elektrik nr. 21030268 nuk është i regjistruar në CCP, konsumatori është i lidhur direkt pa matje jashtë njehsorit elektrik .
Provë: Procesverbali i KEK-ut nr. 182461 të datës 19.09.2008
- ✓ Me datë 10.10.2008 KEK-u e ka ngarkuar konsumatorin me ngarkesë për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike me anë të faturës DPR08HP06744 në vlerë 5815.87 €.
Provë: Fatura DPR08HP06744 të datës 10.10.2008
- ✓ Me datë 24.01.2009 konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KEK duke kundërshtuar ngarkesën për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike.
Provë: Ankesa e konsumatorit në KEK

- ✓ Me datë 19.02.2009 Departamenti për Konsumatorë në KEK iu është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar në arsyetimin se kërkesa e konsumatorit nuk mund të korrigojohet për arsye se mungojnë dëshmitë për gjendjen e njehsorit të vjetër.
Provë: Përgjigja e KEK-ut e datës 19.02.2009
- ✓ Me datë 02.03.2009 konsumatori ka apeluar përgjigjen e KEK-ut në DMK të ZRRE-së.
Provë: Ankesa e konsumatorit në DMK të ZRRE-së
- ✓ Me datë 08.12.2009 DMK në pajtim me paragrafin 14.3 të nenit 14 të Rregullit mbi Procedurën për Zgjidhjen e Kontesteve në Sektorin e Energjisë, ka analizuar ankesat e konsumatorëve dhe ka vlerësuar se zyrtarët e autorizuar për inspektimin e pikave matëse gjatë përpilimit të procesverbaleve nuk kanë shënuar shumat e fuqive të shpenzuesve të inventarizuara me rastin e inspektimit të pikave matëse tek konsumatorët komercial dhe industrial ka kthyer në rishqyrtim lëndën e konsumatorit. Sipas kësaj KEK-u ka vepruar në kundërshtim me Nenin 12 të Procedurës së Përkohshme për Identifikimin dhe Parandalimin e Shfrytëzimit të Paautorizuar.
Provë: Shkresa e DMK-së dërguar KEK-ut (Departamentit për Konsumatorë) për rishqyrtimin e ankesave të konsumatorëve
- ✓ Me datë 21.05.2010 Komisioni i KEK-ut në përbërje të stafit përgjegjës të operatorit të rrjetit dhe furnizuesit publik, ka pranuar pjesërisht ankesën e konsumatorit.
Provë: Vendimi i Komisionit të KEK-ut të datës 21.05.2010

DMK në ZRRE duke analizuar të gjitha dëshmitë e paraqitura nga ana e konsumatorit dhe KEK-ut, ka vërejtur se:

- ✓ Pasi që DMK e ka dërguar lëndën e konsumatorit në rishqyrtim në KEK, punëtorët e autorizuar të KEK-ut kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit me datë 24.02.2010 për të marrë pajisjet elektrike që posedon konsumatori.
Provë: Procesverbali i KEK-ut nr. 169042 të datës 24.02.2010
- ✓ Komisioni i KEK-ut pasi ka marrë lëndën e konsumatorit në rishqyrtim, ka analizuar ankesën e konsumatorit dhe ka refuzuar ankesën e konsumatorit në arsyetimin se: “Konsumatori sipas procesverbalit nr. 182461 dt. 30.06.2008 ka qenë duke u furnizuar drejtpërdrejt nga rrjeti pa matje të energjisë elektrike dhe ka qenë konsumator ilegal. Në bazë të këtij procesverbali shërbimi i faturimit ka llogaritur faturën interne duke u bazuar në seksionin e kabllit 5x2.5mm/2. Sipas kësaj edhe me dt. 10.10.2008 ka rezultuar fatura e RH në vlerë prej 5,815.75 €. Vërejtje: Fatura interne në bazë të cilit llogaritet fatura e RH, sipas Proc. Perk. Për idenë. Dhe paran. Duhet të bazohet në pajisjet të cilat i furnizon pika matëse e jo në siguresa siç është llogaritur RH. Sipas deklaratës së konsumatorit ai këtë lokal e shfrytëzon që nga viti 2004. Rillogaritja e RH me pajisje sipas procesverbalit të kontrollës nr. 095307 rezulton në vlerë 1,994.8 €. Vendimi i komisionit: Mbetet po i njëjti vendim i datës 10.10.2008 në vlerë 5,815.87 €, fatura e RH nr. DPR08HP06744.
Provë: Vendimi i Komisionit të KEK-ut të datës 26.01.2010
- ✓ Komisioni i KEK-ut në vendimin e tyre pas rishqyrtimit të lëndës së konsumatorit ka refuzuar ankesën e konsumatorit në arsyetimin se: në bazë të fakteve dhe parametrave, të paraqitura në procesverbalin nr. 182461 dt. 19.09.2008 konstatojmë se fatura nr. DPR08HP06744 dt. 10.10.2008 në vlerë 5,815.87 € është llogaritur konform nenit 12 të procedurës së përkohshme për identifikimin dhe parandalimin e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë

elektrike. Sipas deklaratës së konsumatorit, ai në lokal dhe në këtë mënyrë është furnizuar me energji elektrike që nga viti 2004. Rillogaritja e RH sipas pajisjeve nga procesverballi nr. 095307 dt. 11.12.2009 rezulton në vlerë 1,994.8 €. Por pasi evidentimi i këtyre pajisjeve është bërë në një periudhë tjetër nga periudha e rikthimit të humbjeve, komisioni qëndron pas vendimit ekzistues.

Provë: Vendimi i Komisionit të KEK-ut të datës 21.05.2010

- ✓ KEK-u edhe përkundër asaj që DMK ka kthyer në rishqyrtim ankesën e konsumatorit dhe i ka konstatuar se KEK nuk ka vepruar sipas nenit 12 të procedurës së përkohshme për identifikimin dhe parandalimin e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike, KEK-u prapë ka refuzuar ankesën e konsumatorit, duke mos e marrë për bazë shkeljen e procedurës.
- ✓ Sipas transaksioneve të konsumatorit vërehet se konsumatori ka filluar të faturohet nga periudha 10/2008. Po ashtu në transaksionet e konsumatorit vërehet se KEK-u konsumatorin me datë 08.10.2008 dhe me datë 10.10.2008 e ka ngarkuar me ngarkesë për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë (rikthim i humbjeve).
Provë: Transaksionet e konsumatorit
- ✓ Sipas Kapitullit të 2 të Procedurës së Përkohshme për Identifikimin dhe parandalimin e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike, shfrytëzimi i energjisë elektrike duke e anashkaluar matjen, konsiderohet shfrytëzim i paautorizuar.
- ✓ Konsumatori ka gabuar që është lidhur direkt në rrjetin e tensionit të ulët pa matje, duke anashkaluar njehsorin elektrik dhe se kjo është në kundërshtim me Procedurën përkohshme për Identifikimin dhe parandalimin e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike.
- ✓ KEK-u me rastin e ngarkesës së konsumatorit me shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike, nuk e ka respektuar saktë nenin 12 të Procedurës së Përkohshme për Identifikimin dhe parandalimin e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike, ngase me rastin e identifikimit se konsumatori është kyçur direkt në rrjet pa matje është dashur të regjistroj pajisjet elektrike në lokal.
- ✓ Sipas deklaratës së konsumatorit theksohet se konsumatori ka filluar të punojë në lokalin shoqëror në vitin 2004, ndërsa para konsumatorit kanë punuar edhe disa punëtorë të tjerë. Konsumatori me pranimin e lokalit nuk ka qenë në dijeni për gjendjen e njehsorit elektrik dhe se për pronën është kujdesur ndërmarrja shoqërore dhe se nuk e ka ditur se a është i regjistruar njehsori elektrik. Asnjë faturë e energjisë elektrike prej 2004 konsumatori deklaron se nuk i kanë arritur.
Provë: Deklarata e konsumatorit
- ✓ DMK, duke u bazuar në analizat e bëra dokumenteve të paraqitura nga palët ka vërejtur se konsumatori me rastin e lidhjes direkte në rrjetin e tensionit të ulët pa matje, ka shkelur rregullat dhe procedurat në fuqi saktësisht Kapitullin e 2 të Procedurës së Përkohshme për Identifikimin dhe parandalimin e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike. Fatura e ngarkesës së rikthimit të humbjeve fatura DPR08HP06744 e datës 10.10.2008 në vlerë prej 5,815.87 € të cilën e ka faturuar KEK-u konsumatorin është në kundërshtim me nenin 12 të Procedurës së Përkohshme për Identifikimin dhe parandalimin e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike, ngase KEK-u është dashur të faturojë konsumatorin me ngarkesë për

rikthim të humbjeve duke u bazuar në pajisjet që posedon konsumatori e jo në profilin e kabllit furnizues.

DMK duke marrë parasysh analizat e bëra dhe argumentet e paraqitura, rekomandon Bordin e ZRRE që të **refuzojë pjesërisht** ankesën e konsumatorit dhe të vjen në përfundim se:

1. KEK-u duhet ta shkarkojë konsumatorin nga ngarkesa e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike fatura DPR08HP06744 në vlerë 5,815.87 €, të datës 10.10.2008.
2. KEK-u duhet të ngarkojë konsumatorin me ngarkesë për shfrytëzim të paautorizuar sipas draft faturës së rikthimit të humbjeve në vlerë prej 1994.8 €, e cila draft faturë është llogaritur duke marrë për bazë pajisjet e regjistruar në lokal.

Bordi i ZRRE-së ka rishikuar të gjitha dokumentet dhe argumentet e paraqitura dhe pas analizës së lëndës së konsumatorit ka vendosur që ta **refuzojë pjesërisht** ankesën e konsumatorit për arsyet e paraqitura në rekomandimin e DMK të ZRRE-së.

Sipas këtij vendimi, KEK-u është i obliguar që:

1. KEK-u duhet ta shkarkojë konsumatorin nga ngarkesa e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike fatura DPR08HP06744 në vlerë 5,815.87 €, të datës 10.10.2008.
2. KEK-u duhet të ngarkojë konsumatorin me ngarkesë për shfrytëzim të paautorizuar sipas draft faturës së rikthimit të humbjeve në vlerë prej 1994.8 €, e cila draft faturë është llogaritur duke marrë për bazë pajisjet e regjistruar në lokal

Këshillë Juridike: Kundër këtij Vendimi, pala ka të drejtë të iniciojë procedurë gjyqësore në Gjykatën Kompetente, brenda **katërmëdhjetë (14) ditësh** prej ditës së pranimit të këtij Vendimi.

Bordi i ZRRE-së

Dr. Ali Hamiti, kryesues

Theranda Beqiri, anëtare

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar